



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:050425
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05412502

Ac.nr.5447/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli kryetare e kolegjit, Nehat Idrizi dhe Burim Shala, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Q.Xh. nga Gjilani rr.”.....”, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.A.S., avokate në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Gjilan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Lumnije Latifi, Zyrtare e Lartë Ligjore në Zyrën e Avokatit të Komunës, me objekt kontesti kompensimi i pagave jubilarë dhe ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.851/20 të datës 18.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.851/20 i datës 18.06.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.851/20 të datës 18.06.2021 ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Q.Xh., nga Gjilani, rr.”.....” dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses në emer të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, në vlerë të 75% të një page bazë, t’ia paguaj shumën prej 315.75euro dhe në emer të kërkesës për kompensim të ushqimit për periudhën kohore 18.04.2017-17.04.2021,për 661 ditë pune t’ia paguaj shumën prej 1,322.00euro, apo në shumën e përgjithshme prej 1,637.75 euro, me kamatë ligjore prej 8%,nga dita e paraqitjes së kërkesës tek e paditura, përkatësisht me datën 21.02.2020, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- II.
- III. DETYROHET e paditura komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit,që paditëses Q.Xh., nga Gjilani, rr.”.....” t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore,edhe ate:për përpilimin e padisë,shumën prej 104euro;për përfaqësim në një seancë gjyqësore shumën prej 135euro si dhe për taksë gjyqësore,shumën prej 31euro, apo shumën e tërësishme prej 270 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar, apo aktgjykimi të priset dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Në përgjigjen në ankesë paditësja, përmes përfaqësueses së autorizuar i ka kontestuar si të pabazuara porendimet ankimore të të paditurës, me propozim që ankesa të refuzohet dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet në tërësi. Njëherazi, ka propozuar që të detyrohet e paditura që në emer të përgjigjes në ankesë paditëses t’i paguaj shumën prej 208€, konform numrit tarifor 9 të OAK.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datë 08.04.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që për njëzetë vite përvojë pune, e paditura t’ia paguaj shpërblimin jubilar, ndërsa për periudhën kohore 18.04.2017 – 17.04.2021 për 661 ditë të realizuara në punë, t’ia paguaj shpenzimet në emer të ushqimit ditor nga dy euro në ditë, detyrime këto për të paditurën që dalin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04. 2017, në fuqi në kohën e parashtrimit të padisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar

C.nr.851/20, të datës 18.06.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë si të bazuar duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata ka theksuar se në bazë të provave të administruara u vërtetua se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse e mësimi parashkollor në SH.F.M.U.”.....” dhe se ka përvojë pune 20 vite. Këto fakte gjykata i vërtetoi në bazë të kontratës së punës të datës 01.09.2016 me nr.1806, vërtetimit me nr.538/2019 që vërteton që paditësja është mësimdhënëse e mësimi parashkollor që nga data 01.12.1999. Lartësinë e pagës të cilën paditësja e realizon nga marrëdhënia e punës gjykata e vërtetoi nga pasqyra bankare të lëshuar nga banka TEB ,që vërteton faktin se paditësja realizon pagën bazë në shumë prej 462.28 euro në muaj. Ndërsa nga vërtetimi me numër....., datë 13.07.2020, të lëshuar nga SH.F.M.U ‘’.....’’, në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se paditësja gjatë periudhës kohore prej 18.04.2017 e deri me 17.04.2021 ka realizuar 661 ditë pune. Prandaj, gjykata vendosi t’ia njoh të drejtën paditëses në kompensim të pagës jubilarë për vitet e përvojës së punës si dhe shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të punës, duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe atë mbi bazën e provave materiale të siguruara nga e paditura, nga të cilat prova konstatohet se paditësja në kohën e inicimit të procedurës kontestimore ishte në marrëdhënie pune në SH.F.M.U. ”.....” në Gjilan, në vendin e punës mësimdhënëse e mësimi parashkollor që nga data 01.12.1999. përkatësisht e njëjta kishte 20 vite përvojë pune. Po ashtu nga provat materiale në shkresat e lëndës, gjykata ka vërtetuar edhe lartësinë e pagës bazë të paditëses si dhe ditët e realizuara në punë gjatë periudhës kohore 18.04.2017 e deri me 17.04.2021. Rrjedhimisht, në raport me gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata me aplikimin e të drejtës materiale, vendosi për aprovimin e kërkesëpadisë në lartësinë e gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë të paqëndrueshme janë pretendimet ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi në rastin konkret kërkesëpadia ka mbështetje ligjore në dispozitat e nenit 90 parag.1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, ku përcaktohet

se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me parag.1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me parag.3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me parag.4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive".

Për më shumë, baza juridike e kërkesëpadisë gjen mbështetje në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, nga neni 35, të cilat dispozita në pjesën përkatëse kanë këtë përmbajtje: Neni 35..8 Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë; për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë. Me nenin 35 paragraf 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 përcaktohet se: "*Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*".

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtës, gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: "*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*".

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës lidhur me atë se e paditura nuk ka për detyrim të paguajë pagën jubilarë dhe shpenzimet e ushqimit, me arsyetimin se e njëjta nuk është nënshkruese e kontratës me ç' rast të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 përcaktohet se: "*1. Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut*", ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: "*Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës*".

Nga dispozitat e lartcekura rezulton se në rastin konkret është obligim i të gjitha institucioneve edukativo-arsimore, publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura ti përmbushë, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit bien të paditurën e cila është e detyruar ta përmbushë një detyrim të tillë, andaj edhe një pretendim i tillë del të jetë i pathemeltë të cilin gjykata ankimore vendosi ta refuzoj si të tillë.

Meqenëse nga shkresat e lëndës ka rezultuar se padia është paraqitur gjatë kohës sa ka qenë në fuqi KKA, e miratuar me datë 18.04.2017, ndërsa edhe për periudhën për të cilën kërkesa i referohet kompenzimit të shujtave, në fuqi ishte KKA e datës 22.01.2021, prandaj të paqëndrueshme janë pretendimet ankimore të të paditurës për parashkrim të kërkesës, përderisa me dispozitën e nenit 87 të ligjit për punë përcaktohet se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palës së paditur, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar si të pambështetur kërkesën e të autorizuarës së paditëses për kompensim të shpenzimeve shtesë në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë, pasi kjo parashtrësë nga gjykata e shkallës së dytë vlerësohet si pa ndikim për vendimmarrje, e që në kuptim të nenit 453 të LPK-së, nuk pranohet si shpenzim i domosdoshëm për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5447/2021, datë 27.02.2024

Kryetare e kolegjit

Hunaida Pasuli